



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

Nr. 154 Prot

Tiranë, më 14.10. 2009

VENDIM Nr. 12 dt. 13.10.2009

Në mbështetje të nenit 17, pika 6, të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, ndryshuar me ligjin nr. 9882, dt 28.02.2008, “Për Trashëgiminë Kulturore”, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve në mbledhjen e datës 13.10.2009, pasi shqyrtoi projektet e diskutuara nga Këshilli Shkencor pranë Institutit të Monumenteve të Kulturës:

VENDOSI:

Lidhur me pikën 3 të rendit të ditës, projekti “Lokal Vale Verde”, i cili ndodhet brenda territorit të Kalasë së Tiranës, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve vendosi si më poshtë:

T’i propozojë Këshillit të Ministrave, shpalljen e territorit brenda mureve të kalasë së Tiranës, “Zonë Arkeologjike”.

- Ngarkohet sekretaria teknike, për njoftimin e këtij vendimi.
- Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R
FERDINAND XHAFERRI

SEKRETAR I KKR
PROF. DR. VALTER SHTYLLA